



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.5/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarës G.P, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga V.G.S, avokate nga Istogu, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 25.07.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga V.G.S, avokate nga Istogu, ndaj gjyqtarës G.P, **SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Me datë 05.07.2023, Këshilli Gjyqësor i Kosovës konform nenit 9 par.2 të Ligjit për Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka transmetuar te Autoritetit Kompetent, në këtë rast Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë, ankesën disiplinore të parashtruar nga V.G.S, avokate nga Istogu ndaj gjyqtarës G.P, me arsyetimin se në Gjykatën Themelore në Pejë – Divizioni Civil është duke u zhvilluar procedura kontestimore në lëndën C.nr.109/19, të paditëses I. R, nga fshati K., Komuna S, të cilën e përfaqëson avokat Q.R, kundër të paditurit I. G., nga Peja, të cilin e përfaqëson avokate V.G.S, me bazë juridike ndarje e pasurisë së përbashkët martesore. Në këtë çështje palët kanë pranuar ftesat për seancën e datës 15.06.2023, në ora 10:00, por i autorizuari i palës paditëse përmes parashtrësës së datës 08.06.2023 ka kërkuar shtyrjen e seancës me arsyetimin se paraprakisht, për të njëjtën datë ka pranuar ftesë për seancë në një gjykatë tjetër, të cilën kërkesë për shtyrje të seancën gjykata e ka aprovuar duke e shtyrë seancën për datë 04.07.2023. Me datë 19.06.2023, përfaqësuesja e të paditurit, këtu parashtruesja e ankesës disiplinore e ka pranuar ftesën për seancën e datës 04.07.2023 dhe me datë 20.06.2023, i është drejtuar gjykatës me Kërkesë për shtyrjen e seancës gjyqësore për një datë tjetër me arsyetimin se paraprakisht ka pranuar ftesë për një lëndë tjetër, për të njëjtën datë dhe të njëjtën orë, për çka si provë ja ka bashkëngjitur Procesverbalin e seancës gjyqësore me të cilën ishte caktuar seanca megjithatë, e njëjta ka theksuar se pasditen e datës 04.07.2023, ka pranuar Procesverbalin C.nr.109/19, të datës 04.07.2023, me të cilin gjykata ka aprovuar propozimin e të autorizuarit të palës paditëse që seanca të mbahet në mungesë të të autorizuarës së të paditurit, me arsyetimin se në kërkesën e saj të datës 20.06.2023 nuk është bashkëngjitur asnjë provë e cila e arsyeton shtyrjen e seancës përkundër faktit se prova ka qenë e bashkëngjitur dhe se gjykata ka pas kohë mjaftueshëm që t'i njoftoj palët për shtyrjen e seancës andaj, këtu parashtruesja e ankesës thekson se mbi bazën e të lartcekurave shihet qartë se gjyqtarja e çështjes duke aprovuar kërkesën e avokatit të palës paditëse për shtyrjen e seancës ndërsa, duke refuzuar kërkesën e të autorizuarës së palës së paditur edhe përkundër faktit se të dy arsyetimet kanë qenë të njëjta, në mënyrë të hapur po e përkrah palën paditëse në të gjitha kërkesat e saj, duke diskriminuar kështu palën e paditur dhe duke e trajtuar çështjen në mënyrë të njëanshme dhe se me këtë sjellje gjyqtarja është duke e vënë të paditurin në pozitë të disfavorshme procedurale, për çfarë ka kërkuar që ndaj gjyqtarës të merren masat e duhura disiplinore.

Parashtruesja e ankesës disiplinore, si provë ankesës së saj ia ka bashkëngjitur: Thirrjen për shqyrtimin kryesor në çështjen C.nr.109/19, për datë 15.06.2023, në ora 10:00, Kërkesën e të autorizuarit të paditëses C.nr.109/19, për shtyrjen e seancës gjyqësore të datës 15.06.2023 së bashku me provën, Thirrjen për shqyrtimin kryesor në çështjen C.nr.109/19, për datë 04.07.2023, në ora 10:00, Kërkesën e të autorizuarës së të paditurit, këtu parashtrueses së ankesës disiplinore, për shtyrje të seancës, Procesverbalin C.nr.2725/21, të datës 18.05.2023, në të cilin gjykata me Aktvendim ka caktuar seancën e radhës për datë 04.07.2023, në ora 10:00, Procesverbalin e seancës gjyqësore në çështjen C.nr.109/19, të datës 04.07.2023 dhe ftesën për seancën gjyqësore të datës 07.09.2023, në ora 10:00.

Me datë 05.07.2023, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për ankesën disiplinore të parashtruar nga V.G.S, avokate nga Istogu, ndaj gjyqtarës G.P.

Gjyqtarja G.P, në deklaratën e saj të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtrueses së ankesës ka deklaruar se nuk qëndron asnjëra nga pretendimet e ngritura nga e autorizuarja e të paditurit për trajtim të pabarabartë të palëve, me pretendimin se seanca e datës 15.06.2023, është shtyrë me kërkesën e të autorizuarit të paditësit, ndërsa seanca e datës 04.07.2023, nuk është shtyrë sipas kërkesë së të autorizuarit të paditurit. E njëjta ka theksuar se si gjyqtare e çështjes, jo vetëm në rastin konkret, por edhe në raste të tjera, kur kërkohet shtyrja e seancës që nuk gjen mbështetje ligjore siç përcakton neni 438 i LPK-së, atëherë vendos vetë me pëlqimin e të dyja palëve si dhe duke vlerësuar edhe rrethanat e tjera në lëndë duke shtuar se në rastin konkret, kërkesa e të autorizuarit të paditësit për shtyrje të seancës, i është dorëzuar të autorizuarës së të paditurit dhe kjo e fundit nuk e ka kundërshtuar shtyrjen dhe gjykata me Shënimin Zyrtar të datës 15.06.2023, e ka shtyre seancën për datë 04.07.2023. Lidhur me kërkesën e të autorizuarës së të paditurit për shtyrjen e seancës, gjyqtarja ka theksuar se është fakt i pakontestueshëm se kërkesa në fjalë nuk është aprovuar mirëpo, konsideron se kjo nuk ka të bëjë fare me trajtim të pabarabartë të palëve pasi mos aprovimi i kërkesës së të autorizuarës së të paditurës për shtyrje të seancës së datës 04.07.2023 kanë qenë për shumë arsye dhe atë : a) vetëm me pëlqim e të dyja palëve e praktikoj shtyrjen seancës kur nuk ka mbështetje ligjore, b) nuk është njoftuar i autorizuarit i paditësit lidhur me kërkesën për shtyrje dhe i njëjti ka udhëtuar së bashku me palën nga Komuna e Skenderajt, c) në seancë kanë prezantuar përveç palës paditëse me të autorizuarin e saj edhe dy ekspertët për t'i mbrojtur ekspertizat e tyre të nxjerra në këtë çështje kontestimore dhe këtë e ka pas të njohur e autorizuarja e të paditurit dhe d) arsyeja kryesore që u kundërshtua shtyrja e seancës edhe nga i autorizuarit i paditëses është se kërkesës për shtyrje të seancës nga e autorizuarja e të paditurit nuk i është bashkëngjitur prova për të vërtetuar arsyen e shtyrjes. Ndërsa, sa i përket pretendimit të autorizuarës së të paditurit se kërkesës për shtyrje ia ka bashkëngjitur provën kjo fare nuk qëndron sepse një provë e tillë nuk është në shkresat e lëndës dhe kjo vërtetohet edhe sipas kërkesës së saj për shtyrje të seancës në të cilën as që është thirrur në provë dhe se një pretendim i tillë, përveç se është jo etik është edhe jo profesional.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarës G.P, së bashku me deklaratën e saj, ka gjetur se ankesa disiplinore është e pabazuar.

Lidhur me pretendimin e parashtrueses së ankesës për shkelje disiplinore nga gjyqtarja G.P, mbështetur në faktin se gjyqtarja e ka aprovuar kërkesën e të autorizuarit të paditësit për shtyrje të seancës me arsyetimin se paraprakisht ka qenë i ftuar në një seancë tjetër të caktuar në të njëjtën datë dhe të njëjtën orë, ndërsa e ka refuzuar kërkesën e të autorizuarës së të paditurit, këtu parashtrueses së ankesës, për shtyrje të seancës edhe pse të dy arsyetimet kanë qenë të njëjta, mbi bazën e të cilave rrethana e njëjta pohon se gjyqtarja në mënyrë të hapur po e përkrah palën paditëse duke e diskriminuar palën e paditur dhe duke e trajtuar çështjen në mënyrë të njëanshme, Kryetari i Gjykatës gjeti se në vlerësim të shkresave të lëndës, rezulton se qëndron deklarimi i gjyqtarës se e autorizuarja e të paditurit, kërkesës

së saj për shtyrje të seancës nuk ja ka bashkëngjitur si provë kopjen e Procesverbalit me të cilën gjykata do të bindej se e njëjta paraprakisht ka qenë e ftuar për një seancë tjetër gjyqësore, të njëjtën ditë dhe orë sikurse seanca e caktuar në lëndën C.nr.109/19. Fakti se e autorizuar e të paditurit, kërkesës së saj për shtyrje të seancës nuk ia ka bashkëngjitur asnjë provë lehtësisht vërtetohet edhe nga Kërkesa për shtyrje të seancës e avokates V.G.S, e datës 19.06.2023, e pranuar në Gjykatë me datë 20.06.2023, të cilën parashtruesja e ankesës disiplinore e ka bashkëngjitur si provë në ankesën disiplinore, në të cilën e autorizuar e të paditurit nuk citon të ketë dorëzuar ndonjë provë bashkëngjitur kërkesës së saj përveç konstatimit se “ Meqenëse me datë 04.07.2023, në ora 10:00 paraprakisht kam pasur të caktuar një seancë tjetër në Gjykatën Themelore në Pejë te gjyqtari Ilir Berisha me numër të lëndës C.nr.2725/21, e kam të pamundshme të marrë pjesë në seancën e caktuar te ju në orën 10:00. Prandaj ju lutem që të keni mirëkuptim dhe seancën e datës 04.07.2023, ta shtyni për një datë tjetër”.

Mbi bazën e të lartcekurave, e duke e pas parasysh se në seancën gjyqësore të caktuar nga gjyqtarja G.P rezulton se prezent kanë qenë të gjitha palët e ftuara ndërsa, e autorizuar e të paditurit ka kërkuar shtyrjen e seancës vetëm me deklaram të thjeshtë e të pambështetur në asnjë provë duke e ditur se konform dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet dhe provat mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, fakti se gjyqtarja ka vazhduar mbajtjen e seancës gjyqësore në mungesë të të autorizuarës së të paditurës nuk mund të trajtohet si shkelje e natyrës disiplinore, pasi e njëjta duke u gjendur në rrethana kur shtyrja e seancës nuk është kërkuar për arsyet e përcaktuara taksativisht me nenin 438 të LPK-së, duke marrë për bazë edhe rrethanat e rastit, ka vazhduar me mbajtjen e seancës gjyqësore në mungesë të të autorizuarës së palës së paditur.

Përfundimisht, Kryetari i Gjykatës gjen se në veprimet e gjyqtares G.P nuk qëndrojnë elemente të shkeljeve të natyrës disiplinore dhe pretendimi se seanca gjyqësore është mbajtur në mungesë të ndonjë pale në kundërshtim me ligjin, është pretendim ankimor për të cilin vendos Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë me kompetencë dhe autorizime për të vlerësuar ligjshmërinë dhe saktësinë e vendimeve dhe veprimeve të gjykatës së shkallës së parë.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.5/23, me datë 25.07.2023

Kryetari i Gjykatës

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtares G.P*
- 3. Parashtrueses së ankesës – V.G.S, avokate në Istog.*